VENDIM
Nr.867, datë 18.6.2008

PËR MIRATIMIN E RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË VLERËSIMIT TË OFERTAVE DHE SHPALLJEN E FITUESIT PËR PRIVATIZIMIN E "ARMO" SHA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 8 të ligjit nr.9117, datë 24.7.2003 "Për përcaktimin e formës dhe të strukturës së formulës së privatizimit të shoqërisë anonime "ARMO"" dhe në vijim të vendimit nr.82, datë 3.2.2008 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e instruksioneve për paraqitjen, hapjen dhe vlerësimin e ofertave për privatizimin e "ARMO" sh.a.-së", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e raportit përfundimtar të vlerësimit të ofertave për privatizimin e "ARMO" sh.a.-së, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, në zbatim të vendimit nr.82, datë 3.2.2008 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, dhe klasifikimin e kandidatëve, si më poshtë vijon:

- Refinery Associates of Texas, Anica Enterprises & Mercuria Energy Group 93.16 pikë;
- Vitol, Euroil sha, NFS Partners SA and USBCF Inc 69.49 pikë;
- Petrofac Energy Developments International Limited 30.52 pikë.

2. Shpalljen fitues të ofertës së paraqitur nga kandidati "Refinery Associates of Texas, Anica Enterprises & Mercuria Energy Group".

3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, që, në bazë të klasifikimit të përcaktuar në pikat 1 e 2 të këtij vendimi, të fillojë negocimet dhe nënshkrimin e marrëveshjes me kandidatin fitues "Refinery Associates of Texas, Anica Enterprises & Mercuria Energy Group", sipas kapitullit VIII, pikat 2 e 3, të vendimit nr.82, datë 3.2.2008 të Këshillit të Ministrave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.